



KOMUNIKATË

9.01.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e 4-të, shqyrtoi dhe miratoi hetimin dhe rinumrimin e fletëvotimeve për zgjedhjet e Raundit të II-të për kryetar të Komunës së Gjilanit. Kordinatori i QNR-së z. Burim Ahmetaj, e infomoi KQZ-në për përfundimin e procesit të hetimit dhe të rinumrimit për komunën e Gjilanit, me një raport të detajizuar të gjithë procesit. Raporti ka përfshirë numrimin e të gjitha votave.

Gjatë prezantimit të raportit, z. Burim Ahmetaj, ka thënë se ndryshimi i rezultateve nga procesi i hetimit dhe rinumrimit ka qenë vetëm 14 vota me rastin e rinumrimit. Anëtarët e KQZ-së në mbledhje, kanë debatuar lidhur me raportin. Komisioni Qendror Zgjedhor, e ka miratuar raportin e QNR-së me 8 vota për, dhe 3 vota kundër.